



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 97 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27 / 08 / 2024

**VENDIM**

Nr. 19 datë 27 / 08 / 2024

**PËR**

**PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT**

**“RIKONSTRUKSION I DIGËS SË UJËMBLEDHËSIT TË FARKËS , FAZA 1 - FURNIZIMI  
DHE VENDOSJA E SISTEMEVE TË MONITORIMIT DHE SISTEMIT TË  
ALARMIT NË DIGËN E FARKËS”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.08.2024 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e paraqitur nga Bashkia Tirane per Rikonstruksion te diges se rezervuarit te Farkes, Faza 1 - FV te sistemeve te monitorimit dhe Sistemit te alarmit ne dige e parashikuar ne kuader te perdorimit te Fondit te programit te emergjencave civile per digat te miratuar ne buxhetin e shtetit per vitin 2024 i cili mbështet politiken kombëtare të parandalimit dhe menaxhimint te fatkeqesive natyrore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se projekti është paraqitur sipas kërkesave të legjislacionit të mesiperm. Duke qene se kjo dige klasifikohet si dige me rrezik te larte per shkak te numrit te njerezve në rrezik qe ndodhen ne zonen urbane poshte saj, ne diskutimet e organizuara gjate takimit, antaret e KKDM vleresuan projektin i cili eshte fokusuar ne monitorimin e diges me instrumenta si dhe ne vendosjen e nje sistemi alarmi modern ne kete dige. Antaret e KKDM vune ne dukje faktin e mungeses së deritanishme te nje sistemi te alarmit ne dige dhe ne zonen poshte saj, mungesen e matjeve te monitorimit te diges me instrumenta te cilat jane kerkesa ligjore per sigurine dhe shfrytezimin e digave te medha. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishem, KKDM:

**VENDOSI:**

- 1- Të miratoj projektin e zbatimit për Rikonstruksionin e digës së rezervuarit të Farkës, Faza 1 - FV të sistemeve të Monitorimit dhe Sistemit të Alarmit në digë të paraqitur nga Bashkia Tiranë
- 2- Ti kërkoj bashkisë Tiranë
  - a. Kontrollin e punimeve dhe caktimin e mbikqyresit te punimeve sipas kerkesave te VKM Nr. 147, date 18.03.2004 “Mbi Miratimin e rregullores per sigurine e digave”, neni 20 dhe 21;
  - b. Të kryej matjet e para të monitorimit të digës me instrumentat e monitorimit te te gjithë sistemet që do të instalohen në digë. Këto matje do të kryhen menjehere pas përfundimit të punimeve. Bazuar në këto matje, duhet të pregatitet një raport i vecante I monitorimit të digës se Farkes i cili duhet të jetë pjesë e projektit të zbatimit sipas faktit që do të zbatohet në terren dhe dokumentacionit teknik të aktit të kolaudimit qe do të dorëzohet në KKDM sipas legjislacionit ne fuqi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- c. Prgatitja e dokumentacionit te duhur te kolaudimit te punimeve dhe miratimin e aktit te Kolaudimit te punimeve sipas kerkesave te VKM Nr. 147, date 18.03.2004, neni 24
- d. Të hartohet plani dhe rregullorja e shfrytezimit, monitorimit, mirembajtjes dhe sigurise së digës pas përfundimit të punimeve per shfrytezimin e saj sipas kerkesave dhe udhëzimeve të dhëna nga KKDM ne Vendimin Nr. 38. date 25.10.2023;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI